

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **ILIR TRANSPORT CAFE SHPK.**

##### **NENI 1**

##### **THEMELIMI DHE EMRI**

Sot me date 01.09.2022, i nenshkruari, Rufat Jashari, shtetas i maqedonise, lindur me date 16.09.1984, ne Deberce, Maqedoni e Veriut, dhe banues ne Deberce, Zheline, Tetove, Maqedoni e Veriut, me numer pasaporte K1156648, me ane te ketij akti themeloi shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "ILIR TRANSPORT CAFE SHPK" (ne vijim referuar si "Shoqeria"), ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

##### **NENI 2**

##### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte kryej Shoqëria do të kryejë aktivitetin e: import – eksport i kafes, perpunim i kafes, import-eksport dhe perpunim i floririt, radiumit, paladiumit, platinin e metaleve te tjera te cmuara, vajit te ullirit dhe vajrave te tjera ushqimore, bizhuterive, veshembathjeve dhe kepuceve, import-eksport i telefonave celulare dhe i aksesoreve te tyre, tregtimi i tyre, import-eksport i makinerive dhe preparateve te cilat sherbejne per perpunimin e ketyre produkteve, si dhe çdo aktivitet tjeter ndihmes dhe te ligjshem ne Republiken e Shqiperise ose jashte saj.

##### **NENI 3**

##### **SELIA**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga Bardhok Biba, Nd. 6, H. 1, Ap. 32, Tirane.

Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesimi dhe filiale ne vendodhje te tjera brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise ne perputhje me kerkesat ligjore te legjislacionit shqiptar.

##### **NENI 4**

##### **KOHEZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

##### **NENI 5**

##### **ORTAKU I VETEM**

Ortaku i vetem i Shoqerise eshte Rufat Jashari, individ, shtetas i maqedonise, lindur me date 16.09.1984, ne Deberce, Maqedoni e Veriut, dhe banues ne Deberce, Zheline, Tetove, Maqedoni e Veriut, me numer pasaporte K1156648.

##### **NENI 6**

##### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke, qe perfaqeson 1 (nje) kuote me vlere nominale 100.000 (njqind mije) leke.

Kapitali eshte nenshkruar nga Ortaku i Vetem zoterues i 100% te kapitalit te Shoqerise.



Pergjegjësia e Ortakut per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

#### NENI 7

#### ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Shoqeria administrohet nga nje ose me shume administratore te emeruar nga Ortaku i vetem.

Administratori do te veprije dhe do te perfaqesoje Shoqerine ne baze te kompetencave dhe mandatit te emerimit te percaktuar sipas legjislacionit shqiptar dhe Statutit te Shoqerise.

Administratori i pare i shoqerise eshte Rufat Jashari, shtetas i maqedonise, lindur me date 16.09.1984, ne Deberce, Maqedoni e Veriut, dhe banues ne Deberce, Zheline, Tetove, Maqedoni e Veriut, me numer pasaporte K1156648.

#### NENI 8

#### VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik.

Perjashtimisht viti i pare financiar fillon me themelimin e Shoqerise dhe perfundon me date 31 Dhjetor te te njejtit vit.

Ky akt themelimi hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje origjinale.

#### ORTAKU I VETEM

#### I SHOQERISE ILIR TRANSPORT CAFE SHPK

RUFAT JASHARI

Rufat Jashari

